



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Elbasan

2017

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) dhe Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (RrFGSh), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet nga QAGJZH dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kundër dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të **Komisionit Evropian**. Programi synon krijimin e një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të mundësuar ulje të fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, dhe nuk reflekton opinionin e Komisionit Evropian dhe UN Women.

Autorët

Mirela Arqimandriti

Denisa Dybeli

Alsonja Hasa

Megi Llubani

Tabela e përmbajtjes

SHKURTIME	4
HYRJE.....	5
METODOLOGJIA.....	7
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR BASHKINË E ELBASANIT.....	9
MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020.....	11
GJETJET KRYESORE	11
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE	13
TABELA E DIVORVCEVE PËR BASHKINË ELBSAN NUK KA TË PËRCAKTUAR ARSYEN. NË KRAHASIM ME BASHKINË VLORË NUMRI I DIVORCEVE NË ELBASAN ËSHTË I DYFISHUAR.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2017.....	15
OBJEKTIVI 3.1: NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	15
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	18
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.	23
REKOMANDIME NË BAZË TË MONITORIMIT TË PUNËS KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE NË BASHKINË ELBASAN.....	23
ANEKS.....	25
ANEKSI 1 – FORUMI I GRUAS ELBASAN.....	25

Lista e tabelave

Tabela 1. Profili i Bashkisë Elbasan	9
Tabela 2. Të dhëna demografike mbi popullsinë e Elbasanit	10
Tabela 3. Raportimet e dhunës me bazë gjinore në rajonet e policisë së Bashkisë Elbasan	Error! Bookmark not defined.
Tabela 4. Raportimet e dhunës me bazë gjinore në Bashkisë Elbasan	14
Tabela 5. Raste të trajtura me NE në Bashkinë Elbasan si kategori e veçantë e pajisur me UM/UMM	15
Tabela 7. Tabela e aktiviteteve të zhvilluar në bashkinë e Elbasanit kundër dhunës në familje	15
Tabela 8. Kalendar i aktiviteteve të përbashkëta mes FGE-së, Bashkisë dhe organizatave partnere për periudhën Tetor- Dhjetor 2017.....	28
Tabela 9. Numri i mbledheve të GTN-së sipas viteve	20
Tabela 10. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve	20
Tabela 11. Tabela e pjesëmarrësve në mbledhjet e KD 2017	21
Tabela 12. Koordinator i vendor kundër dhunës me bazë gjinore.....	22
Tabela 13. Përfaqësuesit e GTN-së së Bashkisë Elbasan	22
Tabela 14. Dhunuesit në sistemin gjyqësor Elbasan	23

Tabela 15. Të dhëna për numrin e përfitueseve në tre shërbimet e FGE-së në tre shërbimet e FGE-së në vite..... 26

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
DhKG	Dhunë ndaj Grave
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
IZhA	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MD	Ministria e Drejtësisë
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MRR	Mekanizmi i Referimit të Rasteve
(MMSR)MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Joqeveritare (Jo-fitimprurëse)
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PShSh	Policia e Shtetit Shqiptar
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZHK “Sot për të Ardhmen”	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
REVALB	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe

	Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Projekti “Ndërtimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020” në lidhje me reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje gjatë periudhës Nëntor 2017 – Tetor 2019. Në Shqipëri projekti zbatohet nga QAGjZh dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kunder dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian. Njësitë administrative të përfshira në monitorim janë bashkitë e Tiranës, Korçës, Shkodrës, Vlorës, Elbasanit, Durrësit. Njëkohësisht, po në kuadër të zbatimit të Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, monitorimi ndërmerret edhe për aktivitetet e planifikuara në nivel kombëtar.

Qëllimi i projektit është krijimi i një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Procesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2010-2020 është duke u zhvilluar përgjatë periudhës Mars 2018 - Shtator 2019. Aktivitetet në nivel qendror do të monitorohen nga QAGjZh dhe RrFGSh përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin e aktiviteteve të PVK 2016-2020 nga të gjitha institucionet përgjegjëse, ndërsa aktivitetet në nivel vendor do të monitorohen nga organizatat lokale, disa prej tyre anëtare të RrFGSh.

Arritjet e pritshme: 1) OShC-të kanë kapacitetet e nevojshme për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020; 2) Procesi i monitorimit nga OShC-të përfundohet me sukses për vitin 2018 dhe 2019; 3) Realizimi i procesit të advokimit nga OShC-të, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e ka nisur punën me organizimin e seancave informuese me OShC-të në 6 bashkitë e synuara, duke vijuar më pas me zhvillimin e një manuali/udhëzuesi për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, për përdorim gjatë trajnimeve me OShC-të lokale që do të monitorojnë Qëllimin Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Përvec manualit u hartuan disa skeda monitoruese të cilat u ndërtuan bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Procesi i monitorimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020 është duke u realizuar në të gjashtë bashkitë, si dhe në nivel qendror, për 2 vite me radhë (2018 dhe 2019). Pjesë e procesit monitorues janë edhe aktivitetet e planit të veprimit të zbatuara gjatë vitit 2017. Të dhënat e mbledhura nga monitoruesit do të analizohen dhe në bazë të kësaj analize do të hartohen raportet (2018, 2019) me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Pas publikimit të raporteve, do të organizohen tryeza të rrumbullakëta në çdo qark lidhur me gjetjet e procesit monitorues, pasuar nga takime advokuese me instancat vendimmarrëse e politikëbërëse. Paralelisht, do të bashkëpunohet me profesionistë të medias për të raportuar periodikisht gjetjet dhe rekomandimet e dala përfshirë informimin në mediat sociale, por edhe për të ngritur kapacitetet e tyre rreth raportimit të ndjeshëm gjinor.

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet e raportimeve për vitet 2018 dhe 2019.

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh është një organizatë jo-fitimprurëse, e krijuar në vitin 2009, që punon në fushën e të drejtave të grave dhe vajzave. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti është fuqizimi social, ekonomik, kulturor dhe politik i gruas shqiptare. Rrjeti përbëhet nga 10 organizata të cilat shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë, nga veriu në jug:

- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë
- Forumi i Gruas Elbasan
- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë
- Shoqata e Grave me Probleme Sociale
- Shoqata Unë Gruaja, Pogradec
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë
- Shoqata Agritra Vizion, Peshkopi
- Shoqata Gruaja tek Gruaja, Shkodër
- Shoqata Jona, Sarandë
- Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare, Tiranë

Për **Bashkinë e Elbasanit** monitorimi i mbledhjeve të mekanizmit të referimit, kontaktet, intervistat, marrja e të dhënave dhe raporti u hartua nga monitorueset Denisa Dybeli dhe Alsonja Hasa me ndihmën e antarëve të stafit të FGE-së, Nertila Toli dhe Dhoksi Gjoka.

Forum i Gruas Elbasan (FGE) është një organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar në vitin 1999, e cila operon në Qarkun e Elbasan. Ajo ka si qëllim promovimin e barazisë gjinore në shoqëri si dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të marxhinalizuara të grave në këtë Qark. Dhuna në familje, barazia gjinore, pjesëmarrja aktive e gruas në vendim-marrje, si dhe integrimi i komuniteteve të zonave informale në jetën social-kulturorë të qytetit janë çështjet kryesore në fokus të punës së kësaj organizate.

Përse monitorim i SKBGJ-së nga OSHC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktimat e dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

Organizatat e SHC janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatohet një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se MSHPS, e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGJ 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Dy monitoruese u përzgjodhën për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2017 dhe fillim vitin 2018.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht: Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
 - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
 - Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGJ në luftën kundër dhunës në familje.

- Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuere të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGJ sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGJ duke identifikuar nga njëra anë praktikatat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGJ.


Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t'i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MSHMS në nivel qendror në adresën WWW.revalb.org

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: 1) hartimin e politikave; 2) matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore të ngritura në nivel lokal; 3) përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; 4) në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; 5) kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; 6) për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

Të dhëna të përgjithshme për bashkinë e Elbasanit.

Figura 1. Harta Administrative e Bashkisë Elbasan



Burimi: UNDP. STAR 2. Qeverisja Vendore – Vetë vlerësime e perceptime, Bashkia Elbasan

Bashkia Elbasan është qendra më e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut me të njëjtin emër. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Elbasan përfshin nën juridiksionin e saj administrativ, qytetin e Elbasanit si dhe 12 njësi administrative, të cilat janë: Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Gjinar, Shushicë, Gjergjan, Funar, Shirgjan, Tregan, Gracen, Bradashesh, Zavalinë dhe Papër. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Elbasanit dhe Qarkut të Elbasanit.

Pas Reformës Administrative Territoriale, Bashkia Elbasan ka 18 njësi administrative. Bashkia Elbasan ka nën administrimin e saj 1 qytet dhe 116 fshatra dhe numëron një popullsi prej 205.412 banorë dhe densitet prej 236,11 banorë për km².

Tabela 1. Profili i Bashkisë Elbasan

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative	Fshatrat në përbërje
Elbasan	Qyteti Elbasan	Elbasan	Qyteti Elbasan, 6 Rajone ose NJ.A
		Labinot-Fushë	Labinot-Fushë, Godolesh, Griqan i Sipërm, Griqan i Poshtem, Xibrakë, Mengel
		Labinot-Mal	Labinot-Mal, Guri Zi, Sericë, Lamollë, Benë, Lugaxhi, Qafë, Qerret, Shmil, Dritas
		Gjinat	Gjinat, Lleshan, Valesh, Pashtresh, Derstilë, Lukan, Sterstan, Xibresh, Maskarth, Kaferr, Pobrat
		Shushicë	Shushicë, Shelcan, Mlizë, Hajdaran, Fush-Bull, Vasjan, Polis i Vogël, Polis Vale, Vreshtaj

		Gjergjan	Gjergjan, Bujaras, Gjonmë, Kështjellë, Kodër Bujaras, Muriqan, Thanë
		Funar	Branesh, Bixëlle, Prec e Sipërme, Cerujë, Korrë, Mollagjesh, Krrabë e Vogël, Prec e Poshtme, Stafaj
		Shirgjan	Shirgjan, Mjekës, Bathes, Bujqës, Jagodinë, Kuqan, Kryezjarr,
		Tregan	Tregan, Blerimas, Bizhdan, Cikallesh, Gurisht, Kacivel, Kyçyk, Muçan, Shinavlash, Shilbater, Trepenisht, Tudan
		Gracen	Gracen, Plangaricë, Tërbaç, Bodin, Shingjin, Gjorm, Pajengë, Mamel, Dopaj;
		Bradashesh	Bradashesh, Balëz Lart, Balëz Poshtë, Kusarth, Kozan, Karakullak, Letan, Rrilë, Shtemaj, Ulëm, Katund i Ri, Fikas, Petresh, Shëmhil, Shijon
		Zavalinë	Zavalinë, Seltë, Kamiçan, Joronishtë, Nezhan, Burrishtë
		Papër	Papër, Broshkë, Murras, Valas, Vidhas, Pajun, Bizhutë, Papër-Sallak, Vidhas-Hasgjel, Lugaj, Jatesh, Balldre, Ullishtaj
Totali	B.Elbasan	18	116

Burimi: STAR 2. Raporti i Vetqeverisjes Vendore, Bashkia Elbasan.

Bashkia Elbasan ka një popullsi prej 141,714 banorë, sipas të dhënave nga INSTAT, Census 2011, ndërsa nga të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile është 179,074 dhe 56,022 familje. Kjo bashki ka në përbërjen e saj 1 qytet dhe 116 fshatra.

Tabela 2. Të dhëna demografike mbi popullsinë e Elbasanit

Njesitë administrative	Numri i fshatrave	Numri i Familjeve	Popullsia sipas Regjistrit Civil 2016	Popullsia sipas Census 2011
			Gjithsej	Gjithsej
Elbasan	-	33835	105918	78703
Labinot-Fushë	6	1758	5979	7058
Labinot-Mal	10	1642	5125	5291
Gjinar	11	1439	4424	3478
Shushicë	9	2963	9962	8731
Gjergjan	7	2162	7066	5126
Funar	9	1006	2763	2122
Shirgjan	7	2822	9495	7307
Tregan	12	1229	4078	3036
Gracen	9	619	2235	2192
Bradashesh	16	3525	11748	10700
Zavalinë	6	598	1738	1622
Papër	13	2424	8543	6348
Totali	116	56022	179074	141714

Burimi: STAR 2. Raporti i Vetqeverisjes Vendore, Bashkia Elbasan.

Në lidhje me ndihmën ekonomike sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar të Bashkisë Elbasan, për periudhën Janar - Dhjetor 2017, rezulton si më poshtë:

- Ndihmë ekonomike: Në janar të vitit 2017 merrnin ndihmë ekonomike, 6257 familje, ndërsa në dhjetor 2017, 5961 familje, pra rreth 296 familje më pak, mesatarisht gjatë vitit 2017 kanë marrë ndihmë ekonomike rreth 25.021 persona.
- Ndihmë nga të ardhurat e bashkisë marrin mesatarisht rreth 63 familje në muaj.
- Ndihmë nga fondi i kushtëzuar kanë përfituar rreth 248 familje në janar 2017 ndërsa në dhjetor 2017 rreth 359 familje në muaj përfitojnë këtë lloj ndihme.

Në lidhje me personat me aftësi të kufizuar përfitojnë ndihmë rreth 4939 persona në janar 2017, ndërsa në dhjetor 2017 rreth 5166 persona, pra rreth 227 me shumë. Nga të cilët kujdestarë janë 1026 persona në janar 2017 dhe 1016 persona në dhjetor 2017.

Ndërsa për energjinë elektrike kompensohen rreth 2600 familje dhe 830 persona me aftësi të kufizuar.

Bashkia Elbasan ka në përbërjen e saj 99 kopshte, 55 shkolla 9-vjeçare dhe 8 shkolla të mesme¹.

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet raportimeve për vitet 2018 dhe 2019.

Gjetjet kryesore

Në kuadër të të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020 në Bashkinë e Elbasanit përgjatë vitit 2017 janë zbatuar nisma të rëndësishme si në aspektin e ndërgjegjësimit të popullsisë ashtu edhe përpjekje për ofrimin e shërbimeve të specializuara. Disa nga gjetjet kryesore të identifikuar përgjatë procesit të monitorimit të zbatimit të Objektivit III të SKBGJ (2016 – 2020) renditen si më poshtë:

- Mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës në familje në bashkinë Elbasan funksionon në mënyrë periodike për adresimin e këtyre çështjeve dhe në vartësi të rasteve të paraqitura. Në vitin 2017 në Bashkinë e Elbasanit, Grupi Teknik Ndërdisciplinor ka kryer 12 takime të rregullta dhe ka trajtuar në mënyrë të suksesshme 78 raste të referuara. Këto aktivitete bëjnë që bashkia Elbasan të jetë një nga bashkitë shembull midis 6 bashkive të monitoruara pasi asnjë nga ato nuk isht embledhur 12 herë.
- Bashkia Elbasan ka zhvilluar një sërë aktivitësh ndërgjegjësuese me pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm aktorësh publike dhe jo-publike duke nxitur kështu pjesëmarrjen e të gjitha palëve. Domosdoshmëri mbetet rritja e mbështetjes financiare nga Bashkia dhe

qeveria shqiptare ndaj OSHC-ve që ofrojnë shërbime kundër dhunës për funksionimin e shërbimeve dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjëse.

- Megjithëse e parashikuar në SKBGJ, shërbimet e rehabilitimit për personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore apo dhunë në familje, ofruar nga shoqëria civile lokale nuk përdoren gjerësisht edhe pse i është kërkuar gjykatës të vendosë në UM detyrimin për të ndjekur shërbime rehabilitimi. Paraqitet i nevojshëm një koordinim më i madh ndërmjet të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit në mënyrë që shërbimet ekzistuese të përdoren.
- Ka një prani të konsiderueshme nga komunitetet fetare, të cilat përgjatë vitit 2017 kanë qenë aktivisht të angazhuara në punën e tyre në adresimin e dhunës në familje përmes shërbesave fetare. Megjithatë deri më tani nuk ka bashkërendim të mesazheve sensibilizuese apo trajnime të përfaqësuesve fetarë me pjesëmarrje të autoriteteve lokale. Ndaj, rritja e bashkëpunimit ndërmjet këtyre aktorëve mund të përmirësojë luftën e përbashkët kundër dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje.
- Pavarësisht shtimit të shërbimeve dhe përgjegjësive për rastet që duhen menaxhuar në kuadër të luftës kundër dhunës me bazë gjinore Bashkia Elbasan nuk ka pasur fonde as në vitet e kaluara dhe as në vitin 2017 të dedikuar për NBGj apo aktivitete kundër dhunës. Për rrjedhojë është i domosdoshë alokimi i burimeve financiare dhe njerëzore për menaxhimin e shërbimeve dhe detyrave të shumta me të cilat përballen punonjësit e kësaj fushe në bashki.
- VKM Nr.334, datë 17.2.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” ngarkon një sërë institucionesh publike e jo publike për të punuar, mbështetur e referuar gratë/vajzat, viktime të dhunës në familje duke i plotësuar edhe kërkesën për UMM/UM. Në Bashkinë Elbasan janë vetëm Specialistët e Policisë së Zonës (SPZ) që i plotësojnë një viktime të dhunuar kërkesën për tu pajisur me Urdhër Mbrojtje (UM) ose Urdhra të Menjëhershëm Mbrojtjeje (UMM). Asnjë nga institucionet e tjera të ngarkuara nuk e ka bërë këtë detyrë.
- Sistemi online përditësohet nga koordinatori i dhunës në Bashki sa herë ka raportime, megjithatë ky i fundit ka nevojë për ndryshime që nga Koordinatorin Kombëtar për një akses funksional.
- Një problematikë e hasur në trajtimin e rasteve të viktimave të dhunës në familje me fëmijë nën moshën 18-vjeç është pagesa e psikologut në gjykatë, e cila është një pagesë që shpesh nuk përballohet dot financiarisht nga viktimat.
- Pavarësisht detyrimit ligjor për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës në familje, ky lloj shërbimi mbetet gjerësisht i pa-aksesueshëm për gratë e dhunuara dhe të trafikuar veçanërisht për komunitetin Rom dhe Egjiptian, sepse ata nuk mund të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm, veçanërisht dëshmi të vendbanimit të tyre ose të ndihmës ekonomike/të ardhurave.
- Një prej mangësive më të mëdha që vihet re nga monitorimi i zbatimit të strategjisë lidhet me Shërbimin e Provës. Sipas të dhënave të përfutuara nuk ka një bashkëpunim apo marrëveshje me shërbimin e provës dhe të dhënat e publikuara nga shërbimi i provës nuk janë të disagreguara sipas llojit të krimit, diçka që do të lehtësonte identifikimin e rasteve të dhunës në familje që kanë marrë dënime alternative.
- Në Elbasan funksionon sistemi i referimit të ndërmjetësimit mes institucioneve publike si Zyra e punës, Qendra e Formimit Profesional, Zyra e informacionit e të strehimit në Bashkinë Elbasan, ku referohen raste konkrete për punësim e strehim. Në tryezat Teknike të organizuara nga Bashkia Elbasan diskutohen raste konkrete të viktimave të dhunës dhe

merret përsipër zgjidhja e problematikave nga përfaqësuesit e Zyrës së Punës, Ndhmës Ekonomike, Strehimit, Shërbimi Social Shtetëror dhe OJF-të.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e Dhunës në Familje

Drejtoria Vendore e Policisë Qarkut Elbasan ka në vartësi të saj 5 komisariate, përkatësisht Bashkia Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cerrik, Peqin si dhe dy Posta policie në Bashkinë Belsh dhe Përrenjas. Puna e policisë në mbështetje të grave të dhunuara është pozitive.

Viktimat shprehen se SPZ-të janë ata që i presin, i marrin deklaratat, i orientojnë se ku duhet të shkojnë për të marrë ndihmë të mëtejshme, duke i referuar e shoqëruar tek kordinatorja e dhunës në Bashkinë Elbasan dhe FGE.

Për arsyen që SPZ-të lëvizin shumë për shkak të detyrës, FGE ka organizuar trajnime të shpeshta me SPZ-të për DHF. Trajnimet konsistojnë në informimin të SPZ-ve në lidhje me DHF, plotësimin e UMM/UM, mikpritjen e viktimave të dhunës dhe fëmijëve dhe referimin sipas rastit. FGE tregon kujdes të vazhdueshëm për të mbajtur lidhje dhe informuar SPZ-të në mënyrë që të shmangen konfliktet e incidentet e mëvonshme të dhunës e për të siguruar jetën e viktimave dhe fëmijëve të tyre.

Sipas tabelës më poshtë, gjatë vitit 2017 kanë qenë 181 raste të dhunës në familje, të raportuara dhe evidentuara nga policia. Gjatë vitit 2017 nuk ka patur vrasje apo tentativa për vrasje. Janë epërgatitur 112 kërkesë padi për urdhër mbrojtje nga të cilat janë shkelur 5. Ka pasur 52 raste të veprës penale sipas nenit 130/a me 27 autorë të arrestuar.

Tabela 3. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Elbasan

Dhuna në familje	Bashkia Elbasan
Raste të evidentuar	181
Vrasje raste	0
Viktima	0
Kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje	112
Shkelje Urdhër Mbrojtje	5
Vepër penale- Neni 130/a	52
Autorë të arrestuar	27
Autorë të ndaluar	3
Autorë të shpallur në kërkim	5
Autorë në gjendje të lire	21
Autorë të vetvuarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit

Tabela 4. Raportimet e dhunës me bazë gjinore në Bashkisë Elbasan

Të dhëna në lidhje me rastet e dhunës në familje	Viti 2017
Nr i rasteve të dhunës në familje	78
Nr. i rasteve të pajisur me UMM/UM	57
Nr.i rasteve pa UM	19
Nr.i rasteve që i është rrëzuar kërkesë padia nga gjykata për UM	2

Burimi: Bashkia Elbasan

Mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Elbasan funksionon rregullisht dhe mblihet në mënyrë periodike për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Bashkia Elbasan ka organizuar disa fushata ndërgjegjësuere për çështje në lidhje me të drejtat dhe fuqizimin e grave e vajzave. Gjithashtu MKR-ja ka dhënë mbështetje të dedikuara sipas rasteve.

Gjatë vitit 2017 MKR-ja Elbasan ka trajtuar 78 raste të viktimave të dhunës në familje, nga të cilët vetëm një rast i përket etnisë rome, 10 komunitetit egjiptian, dhe dy raste të refuzuara nga Gjykata për tu dhënë Urdhër Mbrojtje.

Në 76 rastet e trajtuara nga bashkia, treguesit janë si më poshtë:

- mbështetje psiko sociale dhe emocionale, 76 raste
- konsulencë dhe mbështetje ligjore, 18 raste
- strehim emergjent, 12 raste
- mbështetje ekonomike si rast në nevojë ose për shkak të UM, 49 raste
- paketë ushqimore, 18 raste
- sipas specifikave të rastit, gjetjen e banesës me qera, 3 raste
- kujdes shëndetsore, mundësimi i ilaceve për nënat dhe fëmijet e tyre, 52 raste
- referimi për ndjekjen e një kursi profesional, 48 raste
- punësimi i rastit duke koordinuar me Zyrën Rajonale të Punësimit , 3 raste
- pagesa e çerdhes, 2 raste
- pagesa e kopshtit, 8 raste
- pajisia me libra dhe mjete shkollore e fëmijeve, 26 fëmije
- janë trajtuar për strehim me bonus social, 5 raste të grave viktimave të DHF.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Elbasan gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017 ka trajtuar mesatarisht 30 raste të DHF, të cilat janë referuar tek Njësitë Administrative për tWu orientuar mbi aplikimin për përfitim të pagesës nga UM dhe UMM. Kjo drejtori bashkëpunon dhe koordinon me të gjithë aktorët që janë pjesë e MKR-së, dhe referojnë raste. Nëse kërkohet nga bashkia, rastet bëhen pjesë e vlerësimit në familje. Duke qenë se viktimat me UM dhe UMM trajtohen si përfituese të Ndihmës Ekonomike (NE), kjo drejtori i referon edhe tek Zyra e Punës për punësim, ose ndërmjetësim për kurse profesionale.

Sipas evidencave, përgjatë vitit 2017 (janar – dhjetor) 30 rastet e trajtuara me NE në Bashkinë e Elbasanit si kategori e veçantë e pajisur me UM/UMM, janë të mbartura sipas tabelës. Kjo, bazuar

në UM e përfituara me afate kohore nga 2, 3, 6, 9 dhe 12 muaj, të cilat ripërsëriten ose marrin zgjidhje.

Tabela 5. Raste të trajtura me NE në Bashkinë Elbasan si kategori e veçantë e pajisur me UM/UMM

Viti 2017	Raste/persona
Janar	22
Shkurt	25
Mars	30
Prill	30
Maj	32
Qershor	25
Korrik	16
Gusht	16
Shtator	22
Tetor	29
Nëntor	28
Dhjetor	25

Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Elbasan

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2017

Objektivi 3.1: Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Për vitin 2017 Bashkia Elbasan në bashkëpunim me OJF-të si: FGE, Tjetër Vizion, Eorld Vizion, A2B, si dhe institucione publike pjesë e mekanizmit referues ka realizuar disa fushata ndërgjegjësuese si:

- Fushata lokale per Adresimin e Çështjeve të Mbrojtjes së Fëmijeve dhe Barazisë Gjinore;
- Fushata 16 Ditët e Aktivizmit për Barazinë Gjinore dhe kundër dhunës në familje si: “Fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”.
- Aktiviteti përmyllës i kësaj fushate ishte takimi i Komitetit Drejtues për “Sfidat e dhunës në familje për vitin 2017”, me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve lokalë të parashikuar në ligj.

Tabela 6. Tabela e aktiviteteve të zhvilluar në bashkinë e Elbasanit kundër dhunës në familje

Data	Vendi	Aktiviteti	Intitucioni/Organizata
06.03.2017	Universiteti Aleksandër Xhuvani, dega: infermieri	Takim informues me studentët me tematikë: “Dhuna në Familje”	Shoqata: Tjetër Vizion

07.03.2017	Shoqata “Tjetër Vizion”	Takim informues me përfituese (gra/vajza) me tematike: “Kanceri i gjirit dhe parandalimi i tij”	Bashkia Elbasan; Zyra e Promocionit; Drejtoria e Shëndetit Publik; Shoqata Tjetër Vizion
08.03.2017	Forumi i Gruas Elbasan	Takim me përfitueset:: Pako ushqimore; - Shërbim parukerie	Bashkia Elbasan, FGE
08.03.2017	Teatri “Skampa”	Aktivitetin ndërgjegjësues me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas	Bashkia Elbasan, FGE
10.03.2017	Shkolla “Mahmud Ali Cungu”	Takim informues me nxënësit me tematikë:	Bashkia Elbasan
10.03.2017	Shkolla “Mahmud Ali Cungu”	“Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje?”	-Bashkia Elbasan
21.03.2017	Shkolla “Mahir Domi”	Takim informues me nxënësit: “Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje?”	Bashkia Elbasan, - Psikologia e shkollës Sonila Luzi
		Takim informues me nxënësit: “Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje?”	-Bashkia Elbasan
23.03.2017	Shkolla “Sul Harri”		-Psikologia e shkollës Sonila Luzi
28.03.2017	Shoqata “Ndihmë për Ballkanin”	Takim informues me përfituese(gra/vajza) me tematikë: “Kanceri i gjirit dhe parandalimi i tij”	Bashkia Elbasan-Zyra e Promocionit, Drejtoria e Shëndetit Publik, - Shoqata A2B
		Takim informues me nxënësit:	Bashkia Elbasan
29.03.2017	Shkolla “Vasil Kamami”	“Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje?”	Psikologia e shkollës Sonila Luzi
30.03.2017	Fakulteti i Shkencave të Edukimit; Dega: Punë Sociale, Niveli Bachelor	Takim informues me studentet: “Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje?”	Bashkia Elbasan
31.03.2017	Fakulteti i Shkencave të Edukimit; Dega: Punë Sociale, Niveli Master	Takim informues me studentët: “Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje?”	Bashkia Elbasan

Burimi: Bashkia Elbasan

Nga mbledhja e të dhënave rezulton se Bashkia Elbasan ka realizuar shumë aktivitete kundër dhunës në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile dhe me institucione të tjera. Aktivitete me të detajuar gjenden në aneksin 3 të këtij raporti.

Në bazë të materialeve të mbledhura rreth aktiviteteve ndërgjegjësuere për vitin 2017 vihet re pjesëmarrje e një numri të madh aktorësh vendorë, si publikë ashtu edhe privat. Në këto aktivitete, që kanë pasur pjesëmarrje prej më tepër se 5000 personash janë angazhuar institucione publike, si bashkitë e qarkut, Prefektura, Zyra e Punës, DAR, DRSHP, SHSSH, Prokuroria, Gjykata, Përmbarimi, Universiteti i Elbasanit, Shoqata e Romëve, Tjetër Vizion, Eorld Vision, A2B, Forumi i Gruas Elbasan etj.

Sidoqoftë një nga organizatat më të dedikuara në Elbasan kundër dhunës me bazë gjinore është FGE. FGE konkretisht:

- Organizon forume në komunitet me gra/vajza, burra/djem, përfaqësues të pushtetit vendor në lidhje me: DHF, DHBGJ, Trafikimin, Barazinë Gjinore në Politikë dhe Vendimmarrje.
- Realizon materiale ndërgjegjësuere: spote, cikël emisionesh në TV dhe radio, publikime, fletë-palosje, postera, shkrime të ndryshme në median e shkruar dhe sociale.
- Organizon sesione fuqizimi në qendër me gra/vajza përfituese të shërbimeve, të cilat shkëmbejnë eksperiencë, marrin informacion mbi të drejtat e tyre dhe shërbime nga të cilat mund të përfitojnë.

Në Bashkinë Elbasan veprojnë rreth 21 organizata të shoqërisë civile dhe 4 institucione publike lokale të mbështetura nga buxheti i qeverisë qendrore dhe bashkisë si për shembull:

- Qendra sociale Publike “Balashe” –Elbasan, kjo qendër ofron shërbime për komunitetin Rom; shërbime ditore për të moshuarit; PAK.
- Qendra Autizmit Elbasan– ofron terapi zhvillimi, lo-gopedi, fizioterapi.
- Qendra komunitare për shëndetin mendor – ofron shërbime multidisiplinare për çështje të shëndetit mendor.
- Shkolla special “Zëra Jete”, e cila ofron edukim dhe trajnim të fëmijëve me AK mendore e fizike.

Në territorin e Bashkisë Elbasan veprojnë një sërë organizatash të shoqërisë civile, të cilat kanë bërë një punë të shkëlqyer për promovimin e barazisë gjinore, luftën kundër dhunës me bazë gjinore, mbrojtjen e grave e fëmijëve dhe shtresave në nevojë.

- World Vision
- Ndihe me per Ballkanin
- Tjetër Vizion
- Forumi i Gruas Elbasan
- QKZHK
- Food Bank
- Fondacioni Joslin
- Ndihe me Wailhèailmit
- Fondacioni Nene Tereza
- Qendra Komunitare Rome
- Zëri ROM
- SHAO

Megjithëse nuk ka bashkëpunim të dedikuar dhe trajnime të përfaqësuesve fetarë në bashkinë e Elbasanit janë kryer disa aktivitete të cilat kanë pasur për qëllim adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunën në familje duke përfshirë këtu simpoziumet e mbajtura nga kisha katolike dhe ortodokse, sesionet e mbajtura nga klerikët e Kishave Ortodokse, Ungjëllore dhe Xhamitë. Gjithsej janë zhvilluar 5 sesione informimi dhe dy simpoziume. Më tej, përgjatë vitit 2017 janë mbajtur 7 shërbesa fetare nga komuniteti katolik dhe ortodoks në ditën e gruas ku përcillet mesazhi për rolin e gruas dhe për një familje pa dhunë e konflikte.

Bashkia ka miratuar Kartën Evropiane për Barazi të Burrave dhe Grave në Jetën Vendore, (datë 23 shkurt 2017) duke shprehur një angazhim zyrtar ndaj parimit të barazisë me qëllim arritjen e një jete më të mirë për të gjithë banorët pavarësisht gjinisë. Me nënshkrimin e këtij dokumenti Bashkia e Elbasan është angazhuar që të hartojë dhe miratojë “Planin e Veprimit për Barazi Gjinore” dhe ta zbatojë atë në vazhdimësi duke raportuar rregullisht për ecurinë e këtij plani. Ky plan është duke u përgatitur me mbështetjen e UN Eëomen. Në kuadër të këtij plani janë ngritur këto organizma:

- Aleanca e Grave Këshilltare në Këshillin Bashkiak të bashkisë Elbasan
- Komisioni i Barazisë Gjinore, i bashkëngjitur komisioneve të tjera të Këshillit Bashkiak, i cili do të shqyrtojë të gjitha vendimet e Këshillit me këndvështrim gjinor

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Elbasan, në kuadër të zbatimit të ligjit Nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” VKM Nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyren e procedimit të tij” dhe VKM nr. 733, datë 20.10.2016 “Strategjia Kombëtare Për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020” ka të përfshirë në drejtorinë e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar në bashkinë Elbasan:

- Mekanizmin e referimit të dhunës të krijuar me vendim të Këshillit Bashkiak në vitin 2008, i cili bën koordinimin e veprimeve të gjithë aktorëve lokal në luftën kundër dhunës në familje.
- Komitetin Rajonal të luftës kundër trafikimit në nivel Prefekturë.
- Komitetin e Vlerësimit të Nevojave dhe Planifikimit të Shërbimeve Sociale.

Përgjatë vitit 2017 janë zhvilluar 5 trajnime nga ana e MKR për përmirësimin e shërbimeve ndërdisiplinore. Tematikat kanë qenë të ndryshme por më të rëndësishmet janë si më poshtë:

1. Dhënie informacioni, lidhja e viktimave me shërbimet dhe sigurimi i vazhdimësisë së kujdesit nga institucionet/organizatat duke qenë ndërmjetës me OJF-të, policinë, shërbimet shëndetësore, gjykatat, shërbimet sociale.
2. Mbështetje dhe bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse lokale dhe organizma akademike për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme si dhe për programe në mbrojtje të viktimave të dhunës në territorin që ato mbulojnë.

Në vitin 2017 në Bashkinë e Elbasanit, Grupi Teknik Ndërdisciplinor ka kryer 12 takime të rregullta dhe ka trajtuar në mënyrë të suksesshme 78 raste të referuara. Nga këto 57 janë të pajisur me UM, 2 raste të cilave iu është rrëzuar kërkesë padia nga gjykata dhe 19 raste janë trajtuar pa UM (raste të identifikuar nga nëpunësi gjinor). Në MKR marrin pjesë gjithsej 19 institucione, prej të cilave 12 janë institucione publike dhe 7 OJF sipas listës më poshtë:

- Bashkia e Elbasanit
- Përfaqësuesi i strukturës së policisë;
- Përfaqësuesi i gjykatës së rrethit gjyqësor;
- Përfaqësuesi i prokurorisë së rrethit;
- Përfaqësuesi i drejtorisë arsimore;
- Përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik;
- Përfaqësuesi i strukturës për shërbimet;
- Përfaqësuesi i zyrës së përmbarrimit;
- Përfaqësuesi i prefekturës;
- Përfaqësuesi i zyrës përkatëse të punësimit;
- Drejtuesit e organizatave jofitimprurëse që në objekt të veprimtarisë e tyre merren me çështje të dhunës në familje (Shoqata Romeve, Tjeter Vizion, Ëorld Vizion, A2B, QRFP, Forumi i Gruas Elbasan);
- Drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë njësi të qeverisjes vendore, ose në qarkun në juridiksionin e të cilit këto njësi janë;
- Përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare;
- Drejtuesi i Dhomës së Avokatisë së rrethit;

Koordinatori Vendor për Dhunën është krijuar si pozicion në vitin 2010 dhe prej asaj kohe personi që përmbush rolet për këtë pozicion ka mbetur i pandryshuar. Gjatë 2017 janë zhvilluar 4 trajnime të koordinatorëve nga UN Women, trajnim nga UNDP rreth barazisë gjinore dhe dhunës, trajnim në lidhje me çështjet LGBT nga organizata Pink, ndërsa Ëorld Vision e ka trajnuar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Koordinatorja e dhunës dërgon çdo muaj të dhënat përkatëse dhe raportin ecurinë e punës në GTN për çdo mbledhje.

Sistemi online përditësohet nga koordinatori sa herë ka raportime që duhen hedhur në sistem, megjithatë ky i fundit ka nevojë për ndryshime në mënyrë që të funksionojë me më tepër efikasitet. Në Bashkinë Elbasan funksionojnë gjithashtu disa mekanizma mundësues të pjesëmarrjes dhe mbështetjes sociale, përmendim këtu:

- a) **Nëpunësi Gjinor** i cili mbulon edhe Koordinatorin Vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare
- b) **Grupi Teknik Ndërdisciplinor** për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Ky ekip mblidhet çdo muaj dhe sa herë është e nevojshme për rastet emergjente. Për vitin 2017 janë realizuar 12 takime.
- c) **Tryeza Teknike e vajzave/grave**. Janë tryeza të cilat mblidhen për adresimin e çështjeve që kanë në fokus barazinë gjinore, planifikimin e përbashkët me aktorët lokalë për fushata ndërgjegjësuese etj.
- d) **Sistemi i Punonjësve në Gatishmëri për rastet emergjente në rrezik**. Ky sistem përbëhet nga punonjësit e dy sektorëve, përkatësisht: Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore dhe Sektori i Kujdesit të Shtresave në Nevojë dhe Moshës së Tretë. Këta punonjës janë në gatishmëri në bazë të një grafiku të përcaktuar në një kalendar me numrat

e telefonit të punonjësve. Kalendar i punonjësve në gatishmëri është vënë në dispozicion të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Elbasan, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

- e) **Mbështetja e rasteve emergjente që janë në rrezik.** Rasti pasi vlerësohet nga nëpunësi gjinor, NJMF dhe punonjësi i policisë i referohen në dy qendra, përkatësisht Forumi i Gruas Elbasan dhe Tjetër Vizion. Rastet qëndrojnë për disa ditë deri në momentin sa bëhet vlerësim i plotë i rastit dhe pajiset me Urdhër Mbrojtjeje.

Kur rastet kanë nevojë për mbështetje ligjore, nëpunësi gjinor i referon tek shoqata Forumi i Gruas Elbasan e cila ofron ndihmë ligjore falas. Një problematikë e hasur në trajtimin e këtyre rasteve është pagesa e psikologut në gjykatë për procesin e divorcit e cila është një pagesë që shpesh nuk përballohet dot nga rastet e paraqitura. Në këto kushte pagesa ofrohet nga shoqata Tjetër Vizion në mbështetje të grave në nevojë. Për vitin 2017 janë mbështetur 12 raste. Pavarësisht këtyre mekanizmave, ndihma juridike falas mbetet gjerësisht e pa-aksesueshme për gratë e dhunuara dhe të trafikuar veçanërisht për komunitetin Rom dhe Egjiptian, sepse ata nuk mund të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm, veçanërisht dëshmi të vendbanimit të tyre ose të ndihmës ekonomike/të ardhurave.

Rastet e dhunës në familje që janë në rrezik dhe kanë nevojë për strehim afatgjatë dhe shërbime të specializuara i referohen Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, Tiranë dhe Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara, Tiranë. Për vitin 2017 janë referuar 3 raste. Numri i referimeve është i vogël pasi rastet në këto qendra pranohen kur personat janë të pajisur me Urdhër Mbrojtje. Sa i përket buxhetit të bashkisë që i dedikohet ofrimit të shërbimeve në lidhje me dhunën me bazë gjinore, vetëm nga paga e Koordinatorit Vendor të Dhunës që është përgjegjës për koordinimin e iniciativave në këtë fushë është e përfshirë.

Tabela 7. Numri i mbledhjeve të GTN-së sipas viteve

Viti	Mbledhjet e GTN
2014	8
2015	10
2016	10
2017	12

Tabela 8. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve

Viti	Mbledhjet e KD
2014	3
2015	3
2016	4
2017	3

Tabela 9. Tabela e pjesëmarrësve në mbledhjet e KD 2017

N r.	Emër Mbiemër	Institucioni	Pjesëmarrja		
			11.01.2017	10.02.2017	12.12.2017
1	Qazim Sejдини	Kryetar i Bashkisë	Po	Po	Po
3	Arben Dashi	Drejtori i Policisë së Qarkut Elbasan		Po	Po
4	Zija Sulaj	Shefi i Komisarariatit të Policisë	Po	Po	Po
5	Sulejman Kurti	Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kancelar i Gjykatës RR.Gjyqësor,Ledio Sulkuqi	Po kryetari	Po kancelari	Po kancelari
6	Bledi Mustafaraj	Kryetari i Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor		Po	Po
7	Marsida Haxhiu	Drejtoreshë Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror	Po	Po	Po
8	Edri Stafa	Drejtori i Shëndetit Publik	Po	Jo	Po
9	Fatbardha Menalla	Oficeri i policisë për dhunën në familje	Po	Po	Po
11	Merita Tirana	Zyra Përmbartimore Elbasan	Po	Po	Po
12	Sokol Lulgjuraj	Komuniteti Katolik	Po	Po	Jo
13	Arben Ramkaj	Komuniteti Mysliman		Po	Po
14	Haxhi Admir Selmani	Komuniteti Bektashi		Po	Jo
15	Andon Merdani	Komuniteti Ortodoks		Po	Po
16	Edmond Popa	Komuniteti i Biznesit	Po	Po	Po
17	Dhoksa Quku	Forumi i Gruas	Po	Po	Po
18	Diana Kasa	Tjetër Vizion	Po Diana	Po Arjan Cala	Po ArjanCala
19	Ilir Gjoni	Ëorld Vivion	P0	Po	Po
19	Alketa Hasani	A2B	P0	Po	Po
20	Besim Dybeli	Përfaqësues i mediave locale	Po	Po	Po

Burimi, Bashkia Elbasan

Tabela 10. Koordinatori vendor kundër dhunës me bazë gjinore

Viti	Koordinatori Vendor kundër DhBGj
2014	Marsida Sejdini
2015	Marsida Sejdini
2016	Marsida Sejdini
2017	Marsida Sejdini

Tabela 11. Përfaqësuesit e GTN-së së Bashkisë Elbasan

Institucioni	Emër mbiemer i përfaqësuesit në vitin 2017
Bashkia	Marsida Sejdini
Drejtoria e Policisë	Fatbardha Menalla
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Ledio Sulkuqi
Prokuroria e Rrethit	
Drejtoria Arsimore Rajonale	Sonila Luzi
Drejtoria e Shëndetit Publik	Helga Konguli
Zyra e Përmbarimit	Merita Tirana
Prefektura	Eva Bici
Kryetarët e Njërive Administrative	Shiko tabelen bashkëngjitur me poshte
Zyra e Punësimit	Alma Braneshi
Organizata Jo qeveritare	Luljeta Qose,, Enkelejda Mitre,Alketa
Strehezat për viktimat e dhunës	
Komunitete fetare	
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	

Përgjatë periudhës së monitorimit 2017 janë shtuar 5 shërbime në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje:

- Këshillim psiko-social
- Mbështetje juridike
- Referimi për ndjekjen e një kursi profesional
- Punësim i rastit duke koordinuar me Zyrën Rajonale të Punësimit në Elbasan
- Kujdes shëndetësor, mundësim i ilaçeve për fëmijët.

Pavarësisht shtimit të shërbimeve dhe përgjegjësive që duhen menaxhuar në kuadër të luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje nuk ka pasur shtesa në vitin 2017 si në buxhet ashtu edhe në staf. Për rrjedhojë është bërë e domosdoshme alokimi i më tepër burimeve financiare dhe njerëzore për menaxhimin e shërbimeve dhe detyrave të shumta me të cilat përballen punonjësit e kësaj fushe në bashki.

Bashkia Elbasan që nga viti 2010 ka të emëruar një Nëpunëse të Barazisë Gjinore që luan edhe rolin e Koordinatorës Vendore kundër dhunës në familje, ndërkohë që në Planin e Mbrojtjes Sociale 2016-2020 të kësaj Bashkie, është sugjeruar zgjerimi i “Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore”, ku dukshëm vihet re edhe propozimi për ndarjen e funksioneve të

Nëpunës/es së Barazisë Gjinore dhe Koordinator/es Vendor/e kundër dhunës në familje, përmes emërimit të dy personave me kohë të plotë.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Rehabilitimi i dhunuesve dhe personave të dënuar zhvillohet kryesisht nga Shoqata Tjetër Vizion e cila ka hapur shërbimin për këshillimin psiko-social të burrave dhe djemve të dhunshëm në funksion të ri-edukimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Edhe pse në çdo rast dhunuesit janë këshilluar nga nëpunësi gjinor të paraqiten pranë këtij shërbimi, ata nuk pranojnë të marrin këshillim psiko-social. Në këto kushte i është kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan që në masat e mbrojtjes që merr për rastet e dhunës në familje të përfshihet edhe detyrimi për dhunuesit që të paraqiten në këtë shërbim. Kjo problematikë është diskutuar si në mbledhjet e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor edhe në Komitetin Drejtues (sipas VKM 334 dt.17.02.2011) por ende nuk ka pasur raste të dhunës në familje të pajisur me urdhër mbrojtje ku të jetë parashikuar edhe detyrimi që dhunuesi të paraqitet në këtë shërbim. Ka pasur vetëm dy raste ku me vendim gjykate ku dhunuesit janë detyruar të largohen nga banesa dhe aty të qendrojë viktimat e dhunuar me fëmijët.

Një prej mangësive më të mëdha që vihet re nga monitorimi i implementimit të strategjisë lidhet me shërbimin e provës. Sipas të dhënave të përfuara nuk ka një bashkëpunim apo marrëveshje me shërbimin e provës dhe të dhënat e publikuara nga shërbimi i pronës nuk janë të disagreguara sipas llojit të krimit, diçka që do të lehtësonte identifikimin e rasteve të dhunës në familje që kanë marrë dënime alternative.

Tabela 12. Dhunuesit në sistemin gjyqësor Elbasan

Vitet	Nr. i dhunuesve
2014	
2015	
2016	
2017	57 urdhëra ekzekutimi, nga të cilët femër 1

Burimi: Zyra e Shërbimit të Provës Elbasan

Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Elbasan

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Elbasanit, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Elbasan dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Megjithë ngritjen e funksionimit të MKR, mbledhjeve të rregullta të GTN-së, në Bashkinë Elbasan, kërkohet të merren masa për të rritur sigurinë e jetës së grave e fëmijëve të dhunuar.
- Të rritet aksesimi në shërbime për bashkinë e Elbasanit i cili përbën një nga sfidat kryesore në implementimin efektiv të SKBGJ (2016-2020). Nga pikëpamja institucionale ka bashkërendim të mirë të politikave dhe veprimeve ndërmjet institucioneve të ndryshme që përfshihen në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.

- Të nxitet nga ana e shoqërisë civile vendosja e shërbimit të rehabilitimit në vendimet e gjykatës është një hap i mirë, që duhet ndjekur nga përpjekje të gjithë aktorëve të përfshirë për t'u materializuar.
- Të shtohen financimet nga qeveria qendrore në zbatimin e SKBGJ. Kjo e vendos barrën e zbatimit të strategjisë kryesisht tek burimet ekzistuese në nivel lokal. Pavarësisht ekzistencës së organizatave të shoqërisë civile në Elbasan që ofrojnë shërbime në mbështetje të grave dhe vajzave të dhunuara si edhe fëmijët e tyre dhe pavarësisht bashkëpunimit të mirë që ekziston ndërmjet bashkisë dhe këtyre organizatave, mungon mbështetja me burime financiare nga vetë bashkia për këto organizata.
- Të hartohet një platformë online për të rritur informimin qytetar mbi ligjet, politikat dhe angazhimet në nivel lokal për luftën kundër dhunës me bazë gjinore.
- Të rriten kapacitetet e punonjësve të gjitha institucioneve anëtarë të GTN-së, të përfshirë në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes trajnimeve për të menaxhuar me efikasitet rastet që paraqiten.
- Megjithëse përgjegjësitë dhe shërbimet për viktimat e dhunës me bazë gjinore janë shtuar e njëjta gjë nuk mund të thuhet për shtimin e burimeve financiare dhe njerëzore për të përballuar volumin e punës, ndaj këto të fundit duhet të shtohen.
- Masa e ndihmës ekonomike si edhe strehimi për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe kryefamiljare është shpesh e pamjaftueshme për sigurimin e pavarësisë së tyre ekonomike. Pas paisjes me UMM/ UM viktimat edhe pse përfiton 3000 lekë si viktimë dhune vihet para alternativës që të marrë ndihmën sociale si e papunë, ose atë si viktimë dhune. Pagesa prej 3000 lekë është tepër e ulët dhe e pamjaftueshme që ta bëjë viktimën të jetojë e pavarur me fëmijët e saj.
- Për rrjedhojë rritja e masës së ndihmës ekonomike do të ishte me vlerë.
- Të vendosen detyrime ligjore për gjykatat, që të vendosin shërbime rehabilitimi për personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore dhe dhunë në familje. Kjo do të shërbente pasi shërbimi ofrohet tashmë nga organizatat e shoqërisë civile, por shërbimi nuk përdoret, më tepër prej mendësive që e kundërshtojnë atë si praktikë të pranueshme.
- Të përsoset baza ligjore duke përcaktuar detyrime për çdo institucion i përfshirë në VKM nr.334, datë 17.2.2011, Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij, të zbatoje detyrimet që ka.
- Burrat, baballarët nuk paguajnë detyrimin ushqimor, për fëmijët ndaj Zyra Përmbarrimore Elbasan duhet të bëjë evidentimin e pasurive të tyre dhe vënien e sekuestrimit mbi to për të realizuar më pas ekzekutimin e detyrueshëm. Të bëhen ndryshime ligjore lidhur me detyrimin që kanë ish bashkëshorti për pagesën e pensionit ushqimor ndaj fëmijëve, brënda e jashtë Shqipërisë. Për këtë të fundit të ratifikohen nga qeveria marrëveshje me vendet ku shqiptarët punojnë si emigrantë, kryesisht në Itali dhe Greqi.
- Janë shtuar rastet që femijet mbahen peng nga babai dhunues, gruaja detyrohet të largohet nga banesa si pasojë e dhunës dhe nuk ja lejojnë të marre femijet me vete dhe as ti takojë deri sa Gjykata të shprehet për kujdestarinë e femijeve, ndaj gjykatat duhet të shprehen më shpejt.
- Të forcohet zbatimi i ligjit që në rastet e lëshimit të UMM/UM, në vendim të shprehet qartë largimi i dhunuesit dhe jo i të dhunuarës bashkë me fëmijët.
- Të merren masa nga institucionet e drejtësisë për pagesën e taksave të psikologut në gjykatë në rastet e divorcit nga një viktimë dhune, duke pranuar si të tillë (psikolog)

nga institucione publike e OJF, sipas një liste paraprake të miratuar më parë nga Gjykata ose të përdorin fondet e akorduara të Gjykatës.

- Të lobohet për problemet e strehimit. Qeveria qendrore t'i japë fonde Bashkive, për bonuse apo banesa sociale për viktimat e mbijetuara nga dhuna.
- Të ngrihen programe rehabilitimi për dhunesit të cilët në një përqindje të lartë të rasteve janë konsumues të alkoolit, kanë një personalitet të dhunshëm dhe janë të papunë e me arsim të ulët.
- Të rritet puna ndërgjegjësuere e sensibilizuese nga gjithë institucionet e OJF-të. Veçanërisht në shkolla të bëhen aktivitete me vajzat në shkollë për të drejtat e tyre dhe për ti përgatitur si gra e nëna të ardhshme.
- Më tej rekomandohet ngritja dhe fuqizimi me programeve të arsimit profesional dhe më pas të punësimit të viktimave me qëllim fuqizimin e tyre ekonomik.

Aneks

Aneksi 1 – Forumi i Gruas Elbasan

Forum i Gruas Elbasan ofron prej vitesh **shërbime konkrete për gratë/vajzat me probleme dhune në familje/gjinore.**

Drejtimet kryesore të punës së Forumit të Gruas Elbasan përfshijnë:

- Parandalimin e dhunës me Bazë Gjinore dhe trafikimit të qenieve njerëzore.
- Fuqizimin e grave/vajzave me probleme dhune dhe social-ekonomike.
- Ngritjen e kapaciteteve për përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore në lidhje me çështjet gjinore.
- Lobimim dhe advokaci në mbrojtje të të drejtave të grave/vajzave.

E gjithë eksperiencia e FGE tregon për një veprimtari të gjërë duke:

- Ofruar shërbime konkrete në favor të grave dhe vajzave;
- Realizuar fushata sensibilizuese;
- Organizuar trajnime dhe ngritje kapacitetesh.

Shërbimet konkrete për gra/vajza me probleme dhune realizohen nga:

1. Qendra e Këshillimit, ofron shërbime falas në ndihmë të grave/vajzave me probleme dhune dhe social-ekonomike në Qarkun e Elbasanit, por edhe nga Qarqet e tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj. Shërbimet e ofruara nëpërmjet psikologes/punonjëses sociale, janë:

- Mbështetje psikologjike, sociale, individuale dhe në grup;
- Ndërmjetësim me familjarët dhe përfituesit për gjetjen e alternativave drejt zgjidhjes së problemeve;
- Ndërmjetësim në qendrën e Formimit Profesional, në Biznesin Lokal;
- Informim, orientim dhe referim të rasteve për shërbime të tjera alternative të nevojshme të ofruara nga aktorë të tjerë vendor (publikë dhe jopublikë).

Shërbimet e mësipërme ofrohen nëpërmjet:

- **Linjës telefonike**, ku nëpërmjet numrit të telefonit 05425 45-16 përfitueset prezantojnë problemet e tyre duke mbetur anonim.
- **Këshillimit ballë për ballë**, ku vajzat/gratë vijnë direkt në Qendrën e Këshillimit dhe bëjnë prezente problemet dhe shqetësimet e tyre.

2. Studio Avokatore është e vetmja në Qarkun e Elbasanit që ofron shërbim ligjor falas. Shërbimet janë:

- **Konsulencë juridike**, e cila jepet në rastet kur përfituesja kërkon të sqarojë një problem ligjor.
- **Hartimi i akteve juridike**, drejtuar gjykatës për fillimin e çështjeve gjyqësore (kërkesë padi, kërkesa ankimore, etj.) apo drejtuar institucioneve publike për sigurimin e informacionit të nevojshëm për proces gjyqësor (prova shkresore).
- **Mbrojtje ligjore me avokat** për të gjitha përfitueset, që janë viktime të dhunës në familje.

3. Qendra e Kujdesit Ditor (Shelter Emergjence) është e vetmja në gjithë Shqipërinë. Kjo qendër lindi si nevojë e asistimit dhe mbështetjes së viktimave të dhunuara, të cilat denoncojnë dhunuesit e tyre, që janë në rrezik e kërkojnë të pajisjen me UMM.

Shërbimet e ofruara nëpërmjet punonjësës sociale janë:

1. Strehim nga disa orë, deri në 5 ditë, në pritje të marrjes së Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, për vajza/gra dhe fëmijët e tyre nën 18 vjeç.
2. Vazhdim i këshillimit psiko-social-ligjor e mjekësor nga QK dhe SA gjatë ditëve të akomodimit.

Gjatë qëndrimit në QKD, viktimës bashkë me fëmijët u ofrohen kushte normale akomodimi, jetese, ushqimi, veshmbathje në varësi të nevojave. Ruhet fshehtësia, sekreti dhe anonimiteti i çdo përfitueseje si dhe i QKD-së. Me pajisjen e viktimës me UMM bëhet kalimi në një strehëz tjetër me afat më të gjatë, ose rikthimi në banesë, në varësi të rrishtit që paraqet rasti dhe dëshirës së përfitueses.

Tabela 13. Të dhëna për numrin e përfitueseve në tre shërbimet e FGE-së në tre shërbimet e FGE-së në vite

Viti	Qendra këshillimit	Studio Avokatore	Qendra e emergjencës gra	Qendra e emergjencës fëmijë
2014	369	301	38	35
2015	295	238	28	44
2016	439	252	41	52
2017	697	244	44	39

Burimi: Forumi i Gruas Elbasan

Rastet e viktimave të akomoduar kanë qënë me histori ekstreme dhune fizike, psikologjike dhe ekonomike. Dhuna psikologjike është e pranishme me sharje, fyerje, fjalë banale, duke shtuar mosmarrëveshjet e konfliktet. Kjo shoqërohet me dhunë fizike me goditje me grushta, shkelma, kosë bari, hunj gardhi, thikë e deri me mbajtje të sqeparit nën jastik. Janë disa raste ku grate kanë përfunduar në spital për shkak të pasojave nga dhuna e pësuar. Dhuna fizike është shoqëruar me kërcënime e presione për mbyllje goje, për vrasje e heqje qafe, me dhune seksuale dhe ekonomike. Përmendim dy raste ekstreme dhune V.K. me 3 fëmijë. Person me aftësi të kufizuara dhunohej sistematikisht në të gjithë format, jo vetëm nga bashkëshorti por edhe ngas kunati dhe vjehrra. Me mbështetjen e FGE-së, policisë dhe kordinatorës së dhunës në Bashkinë Elbasan, u pajis me UMM/UM dy herë ndaj tyre. Ndoqi kurs trajnimi profesional, mbështetje me paketa ushqimore, libra, veshje. Me kurajo dhe vendosmëri nuk u largua nga banesa të cilën e kishin ngritur me pune të dy dhe vazhdon të jetoje aty me tre fëmijët e saj, duke ndjekur për cdo shqetësim rrugën ligjore.

Sot numërohet nga rastet e sukseshme. Përmendim edhe rastin L.L. (Egjyptiane) e martuar me dy fëmijë, viktimë e një dhune fizike, ekonomike dhe seksuale nga bashkëshorti. Jetonin në një dhomë bashkë me dy vajzat 16 dhe 10 vjec, ku bashkëshorti e detyronte me dhunë të bente seks në prani edhe të vajzave. Mori shërbimet nga FGE, me mbështetjen e policisë dhe kordinatores së dhunës në Bashkinë Elbasan u pajis me UMM/UM për një vit. U kthye në familjen e origjinës, është punësuar dhe rehabilituar. Por nga kontaktet e vazhdueshme me këto dy përfituese, por edhe të tjera, rezultoi se edhe pse të pajisuar me UMM/UM, ato ende ndjehen të frikësuara e të pasigurta për jetën e tyre si dhe të fëmijëve, nga ngacmimet, kërcënimet, presionet e ish-dhunuesve të tyre.

Në zbutjen e zgjidhjen e problemeve që ka cdo viktimë, dhe në varësi të rastit stafi i FGE-së ka bërë përpjekje të shumta nëpërmjet funksionimit të sistemit të referim- ndërmjetësimit, me qëllim ofrimin e një game më të gjerë të mundësive të ndihmës për përfituesen e fëmijët e saj.

Forumi i Gruas ka të ngritur prej 8 vitesh Rrjetin Rajonal në të cilin bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve publike e jo publike të ngarkuara nga VKM, Nr. 334. Dt.17.02.2011.

Konkretisht pjesë të këtij rrjeti janë:

- Shefki Lika, Drejtuesi i strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë
- Marsida Sejдини, Nëpunësja e barzisë gjinore dhe kordinatore e dhunës në familje
- Fatbardha Menalla, Kordinatore e dhunës në familje e strukturës së policisë
- Ledion Sulkuq, Përfaqësues i gjykatës së rrethit gjyqësor
- Ermira Tafani, Përfaqësuese e prokurorisë së rrethit
- Eglantina Dedja, Përfaqësuese e drejtorisë arsimore
- Edri Stafa, Përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik
- Marsida Haxhiu, Përfaqësuese e Drejtorisë së Shërbimit Social Rajonal
- Alma Braneshi, Përfaqësuese e Zyrës Rajonale të Punësimit
- Viola Henaj, Përfaqësues nga Qendra Publike e Formimit Profesional
- Luljeta Qose, Përfaqësues nga shoqata “Tjetër Vizion”
- Enkelejda Mitre, Përfaqësues nga shoqata, “Eorld Vizion”
- Alketa Hasani, Elona Deliu, Përfaqësues nga shoqata “A2B”
- Eva Bica, Përfaqësues të Institucionit të Prefektit
- Blendi Gremi, Përfaqësues të këshillit të Qarkut

FGE bashkëpunon edhe me drejtuesit e njësive vendore, NJMF-të pranë njësive vendore (aty ku funksionon kjo strukturë) me administratorët social të këtyrë njësive. Mblidhen për ti bërë prezent rastin dhe nevojat që rastet kanë në adresë të pushtetit vendor. Në të gjithë rastet kemi gjetur mbështetjen e mirëkuptimin e tyre si dhe kemi marrë premtimin për ndjekje e zgjidhje të problemit. Theksojmë se për probleme të ndryshme që kanë prezantuar viktimat e akomoduar për vete e fëmijët e si për punësim, trajnim profesional, vijim të shkollave, mungesës së artikujve shkollorë, etj është bashkëpunuar me institucionet e sipërpërmendura që merren më këto.

Sipas rastit, e vendimit të viktimave, është bashkëpunuar me strehëza të tjera si QKTVDHF Tiranë, (Strehëza shtetërore), Strehëza për Gratë e dhunuara Tiranë, “Vatra”Vlorë, “Tjetër Vizion”, “Qendra Linza” ‘Të Ndryshëm por të Barabratë’Tiranë, që kanë afat më të gjatë akomodimi 6 muaj deri në 1 vit.

Nga gjithë këto institucione kemi gjetur gadishmërinë për të na ndihmuar e zbutur problemet e grave të akomoduar. Po përmendim një rast të punës konkrete të funksionimit të rrjetit rajonal dhe tryezës teknike në bashki.

3. Trajnime

FGE ka realizuar trajnime për aktorë të ndryshëm lokalë për tema të cilat kanë patur në qendër çështjet gjinore. Disa prej të cilave janë:

- Trajnim me këshilltarët lokalë mbi ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje.
- Trajnimi i Specialistëve të Policisë së Zonës (SPZ) për nocionet e barazisë gjinore, mënyrën e trajtimit të rasteve të grave të dhunuara, përgatitja e UMM/UM për gratë dhe fëmijët e dhunuar.
- Trajnimi i administratorëve të njësive administrative për përfitimin e ndihmës ekonomike nga viktimat e dhunës në familje të pajisur me UMM/UM.
- Trajnimi i djemve/burrave mbi konceptet e barazisë gjinore, DHF dhe DHBGJ.
- Trajnim lidhës për gratë anëtare/aktiviste të forcave politike dhe shoqërisë civile.
- Sesione informimi me mjekë të familjes.
- Trajnimi i drejtuesve të forcave politike për barazinë gjinore, rolin dhe të drejtat e grave në politikë dhe vendimmarrje.

FGE për realizimin e objektivave të saj bashkëpunon dhe kooperon me institucione shtetërore në nivel qendror/lokal si dhe me shumë organizata partnere, ku mund të përmendim: Tjetër Vizion, Eörd Vizion, “Ndihmë për Ballkanin” “A2B”, “Kolpingu” etj.

Disa nga institucionet shtetërore me të cilat FGE ka marrëveshje bashkëpunimi janë:

- Bashkia Elbasan;
- Drejtoria e Policisë Vendore Elbasan (DPQE);
- Këshilli i Qarkut Elbasan;
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (DRShSSh), Elbasan;
- Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë (DRSH), Elbasan;
- Drejtoria Rajonale Arsimore (DAR), Elbasan;
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Punësimit (DRSHKP), Elbasan;

Gjithashtu, FGE ka një partneritet të zgjeruar me organizata e rrjete kombëtare e ndërkombëtare si më poshtë:

- Komiteti Drejtues dhe Ekipi Teknik për “Mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”;
- Komiteti Rajonal Antitrafik (KRA);
- Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AËEN);
- Qendra Evropiane e Informimit Kundër Dhunës (ËAVE) - Pikë fokale për Shqipërinë.

Tabela 14. Kalendari i aktiviteteve të përbashkëta mes FGE-së, Bashkisë dhe organizatave partnere për periudhën Tetor- Dhjetor 2017

Data	Përshkrimi i aktivitetit	Organizata/Institucioni	Vendi
03/10/2017	Forum në Komunitet, ndërgjegjësim mbi DHBGJ, DHF dhe trafikimin.	Forumi Gruas Elbasan Qendra Komunitare Rome Bashkia Elbasan	Elbasan

4/10/2017	Ndarje të materialeve sensibilizuese në Qendër të Qytetit të Elbasanit. Makinë me foni për përhapjen e mesazheve të Antitrafikut	Institucioni i Prefektit Tjetër Vizion	Sheshi Gensher
05/10/2017	Forum në Komunitet, ndërgjegjësimit mbi DHBGJ, DHF dhe trafikimin.	Forumi Gruas Elbasan Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Elbasan	Elbasan
06/10/2017	Forum në Komunitet, ndërgjegjësimit mbi DHBGJ, DHF dhe trafikimin.	Forumi Gruas Elbasan Bashkia Elbasan Njesia Administrative, Shirgjan	Elbasan
10/10/2017	Takim informues për tumorin e gjirit me mësueset e shkollës “Jorgji Dilo” Ëorkshop “Identifikimi dhe adresimi i nevojave për shërbime për VT/VMT”	DSHP Zyra informimit të edukimit-promovimit shëndetsor	Elbasan Salla e Mbledhjeve në Institucionin e Prefektit; Salla e Mbledhjeve në Këshillin e Qarkut
11/10/2017	Në një ditë të muajit do të bëjmë një forum për tumorin e gjirit me disa të ftuar.	DSHP Zyra informimit të edukimit-promovimit shëndetsor	
12/10/2017	Kontracepsioni dhe tumori i gjirit tek komuniteti Rom	DSHP Zyra informimit të edukimit-promovimit shëndetsor	
12/10/2017	Forum në Komunitet, ndërgjegjësimit mbi DHBGJ, DHF dhe trafikimin.	Forumi Gruas Elbasan Bashkia Elbasan Njesia Administrative, Shushice	Elbasan
16/10/2017	Takim sensibilizues me gratë në komunën Shushicë	DSHP Zyra informimit të edukimit-promovimit shëndetsor	
18/10/2017	Forum në Komunitet, ndërgjegjësimit mbi DHBGJ, DHF dhe trafikimin Takim sensibilizues me gratë në komunën Gjergjan	Forumi Gruas Elbasan Bashkia Elbasan Njesia Administrative, Gjergjan DSHP	Elbasan

		Zyra informimit të edukimit-promovimit shëndetsor	
19/10/2017	Takim sensibilizues në komunën Shirgjan	DSHP Zyra informimit të edukimit-promovimit shëndetsor	
20/10/2017	Aktivitet sensibilizues me fëmijët në Kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Fëmijëve	Bashkia Elbasan Qendra Komunitare Rome Qendra Don Orione	
23/10/2017	Takim sensibilizues në komunën Bradashesh	DSHP Zyra informimit të edukimit-promovimit shëndetsor Shoqata Sfinks	
24/10/2017	Trajnimi I 5 Grupeve të fëmijëve mbi CP R&R-in	Ëorld Vision Elbasan Bashkia Elbasan DRSHSSH	
25/10/2017	Takim me partnere mbi mbrojtjen e fëmijëve	Ëorld Vision Elbasan Të gjithë partneret lokalë	Kuqan , Gjergjan, Mlizë, Shushicë, Kusarth
27/10/2017	Të rinjtë e SHOTA Club do të shprehen nëpërmjet artit kundër DHF dhe DHBGJ. Për muajin Tetor parashikohet vënia në skenë e një drame nga të rinj të shkollave të mesme në ditën portokalli. Ëorkshop “Identifikimi dhe adresimi i nevojave për shërbime për VT/VMT	Forumi Gruas Elbasan Bashkia Elbasan Sh DR.ShSSH Bashkite e Qarkut Tjetër Vizion “Arianiti”	
31/10/2017	Orientim me 90 mësues të 18 shkollave që janë SHQK mbi Shkollën Qendër Komunitare	Ëorld Vision Elbasan	Elbasan

Nentor 1	Tryezë teknike për planifikimin e aktiviteteve të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër DHBGJ dhe DHF. Tryezë teknike për PAK (aktiviteti i 3 Dhjetorit)	Bashkia Elbasan Bashkia Elbasan	Elbasan Shirgjan- Gjergjan, Shushice- Mlize, Kusarth
02/11/2017	Forum në Komunitet, ndërgjegjësime mbi DHBGJ, DHF dhe trafikimin.	Forumi Gruas Elbasan Bashkia Elbasan Njëësia Administrative Bradashesh	Bashkia Elbasan
03/11/2017	Trajnimi i 5 Grupeve të fëmijëve mbi CP R&R-in Tryezë teknike për planifikimin e aktiviteteve në kuadër të 20 Nëntorit, Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të fëmijëve	Ëorld Vision Elbasan Bashkia Elbasan	Elbasan
06/11/2017	<i>-Gjatë muajit Nëntor në shkollat 9-vjecare dhe të mesme bëhet sensibilizim për HIV-AIDS.</i> Takime për konsultime mbi "Planin e Veprimit për Barazi Gjinore" të Bashkisë Elbasan me OJF	Bashkia Elbasan Me mbështetjen e UN ËOMEN	Kuqan , Gjergjan, Mlize, Shushice, Kusarth
08/11/2017	Trajnim/orientim për 16 mësues koordinatorë të 16 shkollave ku punon projekti i Edukimi	Ëorld Vision Elbasan	Shirgjan- Gjergjan, Shushice- Mlize, Kusarth
09/11/2017	Aktivitete ndërgjegjësuese mbi të Drejtat e Fëmijëve		NJA
10/11/2017	Takime për konsultime mbi "Planin e Veprimit për Barazi Gjinore " të Bashkisë Elbasan	Bashkia Elbasan Me mbështetjen e UN ËOMEN	Kuqan , Gjergjan, Mlize, Shushice, Kusarth, Shtermen, Elbasan
13/11/2017	Takime për konsultime mbi "Planin e Veprimit për Barazi Gjinore " të Bashkisë Elbasan	Bashkia Elbasan Me mbështetjen e UN ËOMEN	Rajoni 5 dhe 6

14/11/2017	Takime për konsultime mbi "Planin e Veprimit për Barazi Gjinore " të Bashkisë Elbasan	Bashkia Elbasan Me mbeshtetjen e UN ËOMEN	
15/11/2017	Takime për konsultime mbi "Planin e Veprimit për Barazi Gjinore " të Bashkisë Elbasan	Bashkia Elbasan Me mbeshtetjen e UN ËOMEN	Njesia Administrative Shushice
16/11/2017	Takime për konsultime mbi "Planin e Veprimit për Barazi Gjinore " të Bashkisë Elbasan	Bashkia Elbasan Me mbeshtetjen e UN ËOMEN	Njesia Administrative Gjinar
17/11/2017	Takime për konsultime mbi "Planin e Veprimit për Barazi Gjinore " të Bashkisë Elbasan	Bashkia Elbasan Me mbeshtetjen e UN ËOMEN	Njesia Administrative Bradashesh
23/11/2017	Tryeze teknike për PAK (aktiviteti i 3 Dhjetorit)	Bashkia Elbasan	
24/11/2017	Koncert i Madh në sheshin kryesor të qytetit në kuadër të SHOTA Projekt me sloganin #YouthReact ose #ReagoRini, ku grupe muzikore dhe këngëtarë të qytetit të Elbasanit do të bashkohen dhe do përformojnë për tu shprehur kundër DHF dhe DHBGJ. Ky aktivitet parashikon një impakt të zgjeruar në komunitet dhe reagim ndaj fenomenit. Deklaratë për shtyp për mediat lokale ku tregohet qartë qëllimi i aktivitetit do të përgatitet dhe do shpërndahet atë ditë. Shpërndarja e fjongove, flyer dhe broshura me informacion mbi 25 Nëntorin, Ditën Ndërkombëtare Kundër Dhunës	Forumi Gruas Elbasan Bashkia Elbasan DAR ShSSH OJF Media	
27/11/2017	Trajnim i 3 grupeve të të rriturve mbi CP R&R-in	Ëorld Vision Elbasan	Elbasan
28/11/2017	Trajnim i 3 grupeve të të rriturve mbi CP R&R-in	Ëorld Vision Elbasan	Shirgjan-Gjergjan,

			Shushice-Mlize, Kusarth
29/11/2017	Trajnim i 3 grupeve të të rriturve mbi CP R&R-in	Ëorld Vision Elbasan	Shirgjan-Gjergjan, Shushice-Mlize, Kusarth
30/11/2017	Emision në TV lokale në lidhje me pjesëmarrjen e gruas ne zgjedhje dhe vendim-marrje.	Forumi Gruas Elbasan	Shirgjan-Gjergjan, Shushice-Mlize, Kusarth
01/12/2017	Sesion fuqizimi me gra dhe vajza, përfituese të shërbimeve të FGE në lidhje me kriteret e punësimit dhe strehimit. <i>- 1 Dhjetori -Dita botërore e luftës kundër Hiv/AIDS Dita e të drejtave të njeriut ku ne e shikojmë si të drejtat e njeriut për shëndet dhe shpërndajmë informacione të ndryshme për shëndetin në qendrat shëndetsore.</i>	Forumi Gruas Elbasan Bashkia Elbasan Zyra e Punës DSHP Zyra informimit te edukimit-promovimit shendetsor	Elbasan
04/12/2017	Takim ndërgjegjësues me të rinjtë mbi dhunën në familje dhe dhunën me baze gjinore.	Forumi Gruas Elbasan Bashkia Elbasan DAR	Elbasan
05/12/2017	Takim ndërgjegjësues me të rinjtë mbi dhunën në familje dhe dhunën me baze gjinore.	Forumi Gruas Elbasan Bashkia Elbasan DAR	Elbasan
07/12/2017	Ëorkshop/Konferencë me pjesëmarrjen e aktorëve lokalë në përfundim të 16 Ditëve të Aktivizimit për të diskutuar së bashku mbi arritjet dhe përpjekjet në të ardhmen në luftën kundër DHF dhe DHBGJ.	Forumi Gruas Elbasan Bashkia Elbasan DAR ShSSH OJF Media	
25/12/2017	Transmetimi i Emisionit në TV i realizuar në kundër të SHOTA Projekt me sloganin #YouthReact	Forumi Gruas Elbasan	

	ose #ReagoRini në media lokale.		
--	---------------------------------	--	--